



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Nr:4	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
Data e mbajtjes:	22.07.2025 Ora: 10:05
Vendi i takimit:	Salla e Kuvendit Komunal
Mbledhjen e kryesoi:	Nënkryetari i Komunës: z. Ali Nimanaj
Procesmbajtës:	Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së
Anëtarët e Këshillit:	<ol style="list-style-type: none">1. Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit;2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;3. Shemsedin Zymberaj, Bashkësia Islame;4. Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,5. Jerej Nebojša Sekulliç, Kisha Ortodokse,6. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar;7. Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb;8. Adnan Ramić, Komuniteti Boshnjak;9. Ganimer Shaqiri, Komuniteti Romë;10. Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas;11. Đula Karišik, Komiteti për Komunitete;12. Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore;13. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;14. Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;15. N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK;16. Blerim Gerguri, KLSP-Gurakoc;17. Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;18. Blendineta Shatri, EVSB;19. Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;20. Almina Eqo, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;21. Blendor Isufaj, KVRL;22. Zeqir Mehmetaj, Radio "Fontana";23. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS;24. Armir Arifaj ShKK Burgu i Dubraves, dhe25. Përfaqësuesi i Komuniteti i Biznesit.

	<p>Mungojnë: Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike Adnan Ramiq, Komuniteti Boshnjak Djula Karisik, Komiteti për Komunitete Zeqir Mehmetaj, Radio "Fontana" Armir Arifaj, SH.K.K Burgu i Dubraves Komuniteti i Biznesit</p> <p>Pjesëmarrës tjerë: Arbnor Hashani, FSK Zenel Shatri, Drejtor i Shëndetsisë Abedin Kabashi, DSHP Endrit Mehmetaj, RTV Fontana Jeta Balaj Imeraj, ZIP Mehmed Qeman, përkthyes, Komuna Istog Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit, Komuna Istog</p>
<p>Rendi i ditës:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i Rendit të ditës, 2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit 3. Siguria në zonën e përgjithëshme të PK 4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Sh.K.K "Burgu i Dubraves", Perfaqses të komuniteteve etj.) 5. Gjendja në institucione shëndetsore <ul style="list-style-type: none"> - ordianca.mjekësore -raportet staf-pacient -furnizimi me medikamente (serume kunder pickimit nga gjarprinjt) etj. 6. Parkimi i automjeteve në trotuare-pjerrinat në trotuare, pengohet lëvizja e lirë e qytetërëve në veçanti personat me nevoja të veçanta 7. Qent endacak, sulmi ndaj fëmijëve dhe personave të ndjeshëm 8. Të ndryshme 	

1. Miratimi i rendit të ditës.

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së - Përshëndet të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe gjithë të prënishmit, në veçanti perfaqses të Drejtoret e Drejtorive prezent. I informon anëtarët se Nënkryetari është duke u kthyer nga tereni dhe me lejen e tij po fillojm mbledhjen dhe gjatë mbledhjes do na bashkohet dhe do ta kryesoj mbledhjen. Materialin për mbledhje e keni pranuar me kohë, prezantoi rendin e ditës para të pranishmëve. Konstatoj se nga 24 anëtar të KKSB-së, të prënishëm janë 18 anëtar dhe kemi kuorum për të vazhduar mbledhjen. Në vazhdim pyeti a ka propozime për ndryshim të rendit të ditës pos këtyre që i lajmroj.

Me qe nuk ka propozime tjera, miratohet rendi i dites unanimitisht.

2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së - Pyet anëtarët e KKSB-së të pranishëm në mbledhjen e kaluar a ka dikush vrejtje në ekstraktin e procesverbalit. Me qe nuk ka vrejtje, miratohet ekstrakti i procesverbalit unanimitisht.

Kalojm në pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Siguria në zonën e përgjithshme të PK-së

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së - vazhdojmë me pikën e rendit të ditës, fjalën ja kalon komandantit të Policisë.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog – Situata në zonën e përgjegjësisë është e qet dhe stabile. Stacioni i Policisë vazhdon të punoj në bazë të Planeve Operative si dhe në bazë të Planeve dhe urdhërave nga niveli qendror dhe nga Komanda regionale. Deri në këtë moment që po paraqes raportin për vitin 2025 kemi gjithsej 389 raste të inicuar. Në vazhdim do ti paraqes disa statistika në krahasim me të njëjtën periudh të vitit të kaluar, gjegjësisht krahasimi me gjashtë mujorin e vitit 2024:

- Raste të inicuar, viti 2025 325 raste, ndersa 2024 301 raste e krahasuar me periudhën e njëjt të vitit 2024
- Zbulueshmerua e rasteve viti 2025, 79.2%, ndersa 2024, 74%
- Aksidente trafiku, viti 2025 120 raste,
- Aksidente me lendime viti 2025, 42 raste, ndersa 2024, 27 raste
- Të lënduar viti 2025, 60, ndersa 2024 53
- Tiketa të shqiptuara, viti 2025 3303, ndersa 2024, 3107
- Persona të dyshuar të arrestuar, viti 2025 202, ndersa 2024 186
- Nga të arrestuarit të ndaluar, viti 2025 87 persona, ndersa 2024 62 persona
- Armë të konfiskuara, viti 2025 11, ndersa 2024 21
- Municion të konfiskuar, viti 2025 136 copë, ndersa 2024 137 copë
- Asistime viti 2025 66 raste, ndersa 2024 58 raste
- Raste senzitive, vrasje nuk kemi pas as vitin e kaluar as këtë vit, ndersa lendime të rënda trupore, vitin e kaluar një rast edhe këtë vitë një rast
- Lëndime të lehta trupore, viti 2025 44 raste, ndersa 2024 46 raste
- Viedhje, viti 2025 20 raste, ndersa 2024 29 raste
- Viedhje të rënda, viti 2025 15 raste, ndersa 2024 13 raste
- Dhunë në familje, viti 2025 26 raste, ndersa 2024 22 raste
- E veçanta e këtij mueji kanë qen zjarret, per çka besoj jeni të informuar. Ka pas dëme të konsiderueshme materiale. Numri i përgjithshëm i zjarreve të raportuara kanë qen 12 raste. Pës raste zjarrëvënje, një rastë me kryers të njohur dhe një person i arrestuar, ndersa 4 rastet tjera janë duke u hetuar nga njësitit i hetimeve në bashkëpunim me inspektorin e zjarreve i cili do të del me një raport për shkaktarët e zjarreve. Ndersa 7 raste janë derguar në Prokurori me që dyshohet se disa nga këto raste janë shkaktuar nga rrjeti elektrik.

- Sa ju perket Planeve Operative, kjo kohë është frekuentimi i bashkëatdhetarve, është kohë e dasmave dhe shfrytzoj rastin ti paralajmroj që të gjithë qytetarët të festojn me zëmer e jo me armë dhe fishekzjarre. Policia në të dyja rastet do të intervenoj dhe do ti procesoj rastet sipas Legjislacionit në fuqi.
Kjo do të ishte në pika të shkurta dhe jamë i hapur për pyetje.

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së - falenderoj Kapitenin Gashi dhe hap debatin.

Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb- pyetje për Komandantin e Policisë, kush i ka dhez 4 shtepit e komunitetit Serb 2 në Osojan, një në Llukavc të that dhe 1 në Bllagaq.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog - Në raport e paraqita gjendjen e pergjithëshme dhe kur ishte çeshtja te zjarret nuk i ndava në zona dhe fshatra, janë disa raste që e theksova që ka dyshime të zjarreve në Osojan dhe Llukavc që janë si pasoj e rjetit elektrik dhe janë të procesuara në Prokurori. Të njëjtat vazhdojn të trajthen nga Prokuroria dhe nga Policia me prioritet.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- Kemi informacione se po mbahen gara automobilistike në drejtim të Rakoshit. A keni ju informacione dhe a keni ndermarr diçka.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog - Këtë muej Stacioni i Policisë Istog ka shqiptuar gjithsejt 540 gjoba në komunikacion, kemi konfiskuar disa patentshofer dhe në të gjitha rastet kur ka pas dyshim të bazuar se janë duke bërë gara është vepruar konform legjislacionit.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar - më intereson viedhjet e rana a keni statistik, sa është perqindja e zbulueshmeris të këtyre rasteve dhe një sqarim çka konsiderohet sipas Policisë viedhje e rëndë.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog - Viedhje është kur pasuria e huej mirret me qellim pervetsimit. Hyrja në objekte të mbyllura, rrethuara apo automjet i mbyllur, konsiderohet viedhje e rëndë. Viedhje afer marketeve ku janë thyer automjetet dhe është marr çanta. Kto raste kanë ndodh afer marketit Rina në Banjë dhe Qëndres Tregtare " Mario PX" ku automjetet janë thyer dhe janë marrë çanta dhe gjësende me vlerë dhe në parkingun e " ONIX". Ka pas persona të arrestuar dhe jemi duke i trajtuar me prioritet gjatë gjithë kohes. Cak i këtyre viedhjeve janë edhe shtemit e bashkatdhetarve në mergat si dhe një depo në Banjë dhe janë viedh një sasi e madhe të mjeteve të punës, kryersi i vepresh është nxan dhe lënda është procesu në Prokurori.

Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas- damet e krijuara nga zjarret a do të kompenzohen qytetarët.

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së - Komisioni për vlersimin e dëmeve e ka bërë një njoftim me afatë tetë ditore për paraqitjen e kërkesave (afat i Parapar me Rregulloren për vlersimin e dëmeve) nga qytetarët e dëmtuar. Ky afat ka perfunduar komisioni ka filluar të dal në teren dhe janë në fazën e vlersimit. Komuna nuk ka buxhet për kompenzimin e dëmeve, mirpo nese vlersojm kompenzimin nga Qeveria pas vershimeve të 2022 dhe 2023 që buqësia nuk i ka kompenzuar, nuk mund të japim një pergjigje të sakt a do të kompenzohen. Vlersimet do të kalojn sipas proceduarve dhe do të dorzohen Komisionit Qeveritar i cili do ti proceson në Qeveri dhe pas informatave që do ti kemi nga injëjti do ti njoftojm palët e dëmtuara.

Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas- e kamë një kërkes nga banoret e Rr. Shkoza që të vendoset një penges në rrugë, për shkak se vozitet shpejt dhe janë të rrezikuar këmbësorët.

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSBB-së -për sa une kam informat nga zyrtari për komunikacion nuk e kanë të parapar në tender vendosjen e këtyre pengesave me që ka pas kërkesa enorme dhe të njëjtat paraqesin penges për komunikacion të lirë dhe ndeshkojn shumicen e ngasësve të automjeteve që ju permbahen shenjave të komunikacionit.

Kamë një kërkesë për Komandantin e Policis që qytetarët ma kanë paraqit me shkrim lidhur me bllokaden e rruges nga kamionet e Liridones dhe pengesen që paraqet në Rr. Smajl Bajra automekaniku i cili pothuajse i len automjetet në rrugë.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog - do ti njoftoj patrullat e Policis dhe do të ndermarrin masa në këtë segment rrugor.

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSBB-së -Me që nuk ka diskutime tjera lidhur me këtë pik kalojm në piken e katert të rëndit të ditës.

4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqses të komuniteteve etj.)

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSBB-së - Perfaqsesit e KFOR-it, FSK-së, Arsimit etj fjala është për ju.

Me që nuk ka diskutime lidhur me këtë pik kalojm në piken e pestë të rëndit të ditës.

5. Gjendja në institucione shëndetsore - ordianca mjekësore -raportet staf-pacient

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSBB-së - lidhur me këtë temë fjalën ja kaloj Drejtorit të Drejtoratit të Shëndetsis Dr. Zenel Shatri për ta paraqitur një raport.

Dr. Zenel Shatri, Drejtor i Drejtoratit të Shëndetsisë- lidhur me temën mund të themi se gjendjen e kemi relativisht të mirë, marr parasysh edhe situatën në të cilën jemi aktualisht, me që për shkak të ndertimit të Objektivit të ri të QKMF-së kemi bërë fuzionimin dhe shpërndarjen e disa shërbimeve nëpër QMF-të në Bashkësi Lokale. Emergjencia funksionon 24 orë pa ndërprerje dhe kemi një ekip që ofron shërbime në ambulant dhe një ekip që oron shërbimet në teren. I kemi 4 QMF dhe 8 AMF (ambulanta), e teta është në Fsh. Uçë që tani është hapur. Duke pas parasysh edhe fluksin e bashkatdhetarve pritet të shtohet fluksi i pacientve me smundjet sezonale. Sa i përket raportit ndërmjet stafit shëndetsor është i mirë dhe të njëjtin mund ta konstatojm edhe raportin staf-pacient me disa vërejtje të vogla që nuk ndikojn ndjeshëm në këtë raport. Jemi të furnizuar me barnat nga lista esenciale në QKMF në veçanti atyre në Emergjenc, duke filluar nga Oksigjeni, antishok terapia, Insolina, matis për Insolin, EKG-ja pastaj stafi mjekësor, gjithashtu Emergjencia është e furnizuar edhe me serumin antiviperik kundër kafshimit të gjarpërit. Dhe mjete të nevojshme për lëndime në komunikacion. Laboratori tani punon deri në orën 18.00, laborantët bartin analizat emergjente duke përfshirë edhe hemogramin. Tani ekemi edhe nr. 194 në

emergjenc i cili funksionon nga telefonia fikse dhe nga vala por jo edhe nga telefonia IPKO per momentin.

Jemi të mobilizuar per ofrimin e sherbimeve Emergjencia funksionon 24 orë, paradite i kemi dy ekipe mobile, një per raste emergjente dhe njëna që ofron sherbime shtepiake ndersa pas dite është vetem ekipi mobil emergjent. Mer qe jemi në fazen e ndertimit të objektit të ri në QMF Gurrakoc e kemi Gjinekologjin ku e kemi shtu edhe një sherbim papatectin i cili është jetik për identifikimin e hershem të kancerit të qafes së mitres, andaj ftoj që ta shfrytzojn këtë mundsi të gjithë.

Fillimisht ky do ishte një raport në pika të shkurta. Nese ka pyetje jam i hapur.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- ka ankesa për nivelin e higjenes në sallat e infuzioneve. A keni inspektime dhe a keni ndermarr masa.

Dr. Zenel Shatri, Drejtor i Drejtoratit të Shendetsisë- pa dashur të justifikoj dhe të gjej arsytetime por situata në të cilen ndodhemi është tejet e ngusht hapsira dhe smundjet sezonale nga njëhere janë aq dinamike, smundjet e barkqitjeve dhe vielljeve kerkojn intervenim urgjent por ka momente kur është e pa arritshme. Kam kryer edhe vetë kontrolla por duke pas edhe pervojen e gjatë në Shendetsi ka raste kur është e pa arritshme niveli i 100%, por marr parasysh të gjitha këto që i theksova mund të konstatoj se është një gjendje relativisht e mirë, duke u pajtuar se ka raste të tilla kur për momentin pacienti mund të ketë vrejtje për nivelin e higjenes e cila në një koh optimale permirsohet.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar - më pelqeu shum ekzistenca e ekipit mobil që viziton pacientet në shtepia, me që ka shum raste kur pacienti për arsye të ndryshme nuk mund të shkoj në QKMF. Qysh e vlersoni ju punën e këtij ekipi mobil a funksionon mirë, a e kuptova mirëa funksionon para dhe pas dite. Sa i perket egzistences së numrit emergjent do të ishte mirë që qytetarët të njoftohen permes tv Fontanes apo mënyra tjera, me që unë se kamë ditë dhe po besoj se ka edhe qytetar tjer që nuk janë në dijeni.

Dr. Zenel Shatri, Drejtor i Drejtoratit të Shendetsisë- Ka dikun tre kater muej që është në funksion, e kemi lajmru permes Tv Fontanes, Veb faqes të Komunes bile e kemi paraqit edhe situaten pse nuk funksionon nga telefonia IPKO.

Sa i perket funksionimit të ekipit mobil, vetë si ekspert dhe si mjek 50/50 jam i knaqun. Thirrjet nga njëhere janë të pa nevojshme. Kur shkon ekipi e gjen pacientin tuj pi çaj dhe i njëjti deklarohet mu ngrit tensioni dhe kesh shumë keq. Megjithatë qendrimi imë është më mirë është të intervenoj ekipi sepse mund të ndodh krahasimi i rastit dhe intervenimi i vonshem mund të jet me fatalitet dhe nisur nga ky parim gjithnjë kerkoj që ekipi të del në lokacionin e kerkuar. Sa ju perket pergjigjeve në telefonata mund të ndodh që mos të lajmrohen sepse mund të jetë në intervenim duke dhën gjylper apo fashim, apo infuzion sepse fluksi është i madhë në sezon.

Deri me tani i kemi pas pës raste të kafshimeve të gjarprit edhe pse në njërin rast pacienti nuk ka qën i sigurt a e ka kafshu gjarpri apo jo, megjithate dhenja e serumit nuk është i dëmshëm. Kushtet e punes i kemi tejet të rana kur është i gjith ky fluks i pacientve dhe pacientet janë mësu shum pak i frekuentojn QMF-të edhe pse aty është mjeku dhe tekniku.

Skender Hasangjekaj, koordinator i KKSBS-së - sa ju perket thirrjeve të rrejshme mund ti vendosni paisjet ashtu qysh ika QOE në Pejë dhe numri i telefonit është i

dukshem dhe për një thirrje të tillë do të duhej të ndermerren masa Ligjore me që dalja e ekipit në thirrje të rrëjshme mund tja rrezikoj jetën tjetrit pacient i cili vertet ka nevojë për ekip në të njëjtën kohë. Qytetarët duhen të vetëdijesohen se shërbimi ju ofrohet por e kanë edhe përgjegjësin për moskeqperdorim të shërbimit sepse tjetrit pacient mund ti kushtoj me jetë.

Dr. Zenel Shatri, Drejtor i Drejtoratit të Shëndetsisë- nuk kemi thirrje të rrejshme në atë aspekt, por janë smundje që mund të kontrollohen gjatë ditë në ambulancë dhe jo gjitha rastet janë vertet për trajtim nga ekipi mobil. Poashtu ka kërkesa që të ketë barnatore kujdestare 24orë. Unë nuk pajtohem me që Emergjencia është e furnizuar me gjitha ilaçet emergjente nëse nuk jepin rezultate ilaçet që ne i posedojmë pacienti transportohet në Spitalin e Pejës. Ndoshta do të duhej rregulluar që vikendit të jetë ndonjë farmaci kujdestare ku pacientet gjatë vikendit mund të furnizohen por jo edhe 24 orë sepse është kosto e farmacisë.

Skender Hasangjekaj, koordinator i KKSBB-së -Me që nuk ka diskutime lidhur me këtë pikë kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës.

6. **Parkimi i automjeteve në trotuare-pjerrinat në trotuare, pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve në veçanti personat me nevoja të veçanta**

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSBB-së - lidhur me këtë temë fjalën ja kaloj Drejtorit të Drejtoratit të Shërbimeve Publike Z. Abedin Kabashi për ta paraqitur një raport.

Abedin Kabashi, Drejtorit të Drejtoratit të Shërbimeve Publike- lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk është përgjegjësi ekskluzive e Drejtoratit për Shërbime Publike, me që janë të nderlidhura edhe Drejtorit tjerë si Inspekcioni, Urbanizmi etj, por megjithatë do të tentoj ta jap një sqarim për atë që janë kompetencat tona. Vitin e kaluar i kemi bërë rreth 160 parkingje në Istog, Shesh, në Rr. 2.Korriku dhe gjitha oborret e Shkollave gjatë sezonit verorë, Kryetari ka marrë vendim të hapen dyert dhe të shfrytëzohen për parkingje me që fluksi i bashkëatdhetarëve është i madh andaj dëshirojmë të krijojmë kushte me atë që kemi mundsi. Sa ju përket pjerrinave para dy viteve kemi pasur një projekt dhe së bashku me HENDIKOS-in gjejmë së bashku Lumditin jemi dalë dhe kemi bërë identifikimin e vendkalimeve dhe pjerrinave të nevojshme për krijimin e kushteve të lëvizjes së lirë të komunitetit me nevoja të veçanta. Këtë projekt e ka zbatuar Drejtoria për Mirëqënje Sociale. Vitin e ardhshëm do të ketë edhe investime tjera me që janë bërë disa investime në rrugë dhe trotuare.

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSBB-së -falenderoj Drejtorin dhe hapi debatin lidhur me këtë temë.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog - Policia e ka në implementim Planin Operativ trotuaret e lira dhe besoj i kemi vënë një patrull të Policisë gjatë gjithë ditës me biçikleta që për qellim kanë lirinë e trotuareve.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- z. Komandant dhe z. Kabashi vetëm në Istog kemi trotuare, nuk ka trotuare në drejtime tjeratë fshatrave, a kemi menduar të bënim trotuare edhe në këto pjesë.

Abedin Kabashi, Drejtorit të Drejtoratit të Shërbimeve Publike- faleminderit z. Balaj, edhe në këto pjesë ka përmendur atë që ka Shkollat janë të ndërtuara trotuaret

dhe në vazhdimsi jemi duke ndertuar, me kalimin e kohes duke pas parasysh edhe mundsit buxhetore do tju vie radha edhe vendbanimeve tjera.

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKS-së - Drejtori e theksoj se nuk është pergjegjësi vetem e Drejtoratit për Sherbime Publike dhe unë në pergatitje të mbledhjes i kam dergu ftesat edhe dy Drejtorive tjera, dje kamë bisedu edhe me Inspektorin e Komunikacionit dhe e kam njoftu rreth temes por nuk kamë ndonjë pergjigje pse sot nuk ka ardhur. Ajo çfar do të duhej të trajtohet me theks të veçant janë plotsimi i kushteve të trotuareve egzistuese apo të ndertuara ti plotsojn këto kushte për të verbertit dhe per personat me karroca, por jo vetem sepse edhe nënat me kolica me foshne kan probleme në disa pjesë të trotuareve dhe udhkryqeve. Egzistojn kubza apo pllaka të veçanta për të verbertit në veçanti që duhet vendos në trotuare e në veçanti në vendkalime të rrugve dhe në udhëkryqe. Si duket duhet që të demonstrojm të gjith ne që kemi pergjegjsi në Planifikim dhe zbatim të projektit që të ungjemi në kolica dhe ta shofim njëher sa e veshtir është të lëvizim me karroc apo si i verbert në disa trotuare dhe vëndkalime.

Lumdita Idrizaj, HENDIKOS- po Drejtori e theksoj se kemi qen sbashku në identifikimin e vendkalimeve, trotareve parkingjeve për persona me nevoja të veçanta por nuk po vrehet ndonjë ndryshim i madhë që athere. Disa her kam kerku nga Policia që të ndalojn parkimin e automjeteve në hapsiren dhe në hymjen tek objekti i HENDIKOS-it dhe Policia kalon aty pari dhe nuk reagojn, kur i kam pyet Polict a po pengon kjo vetur këtu në hymje mu kan pergjigj Jo ska problem mundesh me lanë dhe kur ju kam tregu se nuk është vetura ime por kjo po na pengon neve sepse nuk kemi mundsi të dalim nga objekti serish nuk kan ndermarr masa për ta larguar të njëjtin.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog - disa her në këto takime ju kamë than që une jamë i gatshem tju pergjigjem ankesave tuaja. E nderuara Lumdit kerkoni nga unë dhe unë do ta dergoj patrollen ta liroj hyrjen. Nuk e di kush është aj zyrtar policor që ka pas siellje jo të mirë ndaj jushë.

Lumdita Idrizaj, HENDIKOS- u keqkuptumë komandant qytetarët janë siell keq duke thën mos e ke pa pru ti ketë vënd ktu e asht i jyti, jo zyrtart policor që janë siell keq por nuk kan ndermarr masa ndaj pronarve të automjeteve najt qysh merr masa psh. si kur e sheh automjetin para barnatores të ndalur.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog - edhe ndaj qytetarve që kanë siellje të kqia duhet që të vini në Stacion dhe ta lajmroni dhe ne do të ndermarrim masa konform Ligjit.

Skender Hasangjekaj, koordinator i KKS-së - Me që nuk ka diskutime lidhur me këtë pik kalojm në piken e shtatë të rëndit të ditës.

7. Qent endacak, sulmi ndaj fëmijëve dhe personave të ndjeshëm

Skender Hasangjekaj, koordinator i KKS-së - shkaku i angazhimeve të Drejtorit, i njëjti më ka autorizuar mua që ta paraqes një raport lidhur me aktivitetet që i kemi ndermarr deri me tani. E kemi pergatit tenderin bazuar në Ligjin që të bëjm trajtimin e qenve endacak. Në bisedat dhe ankesat që i paraqesin qyterarët e shofim se pritshmeria e tyre është largimi i tersishem nga rruga. Mundsit tona të momentit janë trajtimi i tyre që do të thot sterilizimi dhe vaksinimi i tyre ndërsa në rastet kur janë të

smur dhe paraqesin rrezik athere me injeksion vihet në gjumë. Pas sterilizimit dhe vaksinimit Operatori Ekonomik serish i lshon në vendin e orgjinës që do të thotë ti lëshoj aty ku i ka nxan. Jemi duke bër perpjekje që në bashkpunim me Komunat fqinj të dakordohemi për mundsit e perbashkëta per ngritje të strehimores e cila do të mundsonte largimin e tyre nga rruga. Nga java e ardhshme qytetarët mund ti adresojn shqetsimet në Dretorin e Emergjencave lidhur me këtë temë. Gjithashtu jemi në dijeni se Qeveria e Kosoves e cila tani është në detyr ka filluar me analiza dhe për hartimin e strategjis lidhur me qent endacak në nivel Kosoves.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- z. Në qytetin e Istogut si dhe qytete tjera shofim qën të smur ë dhe të ngordhur të cilët mund të paraqesin pandemiandaj më mirë është të asgjesohen sesa të lihen të ngordhin vend e a vend.

Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas- pyetje per komandantin e Policisë, një kabllo e rrymes është e shtrir neper park dhe mund të paraqet rrezik për qytearët dhe fëmijt që e frekuentojn parkun.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog -posa të dalim nga takimi do të kontaktoj me KEDS-in dhe të ndermarrim masa.

Skender Hasangjekaj, koordinator i KKSB-së - Me që nuk ka diskutime lidhur me këtë pik kalojm në piken e tetë të rëndit të ditës.

8. Të ndryshme

Skender Hasangjekaj, koordinator i KKSB-së -a ka ndonjë antar të hap ndonjë çeshtje apo të diskotoj.

Me që nuk ka ju falenderoj për kontroibutin dhe shihemi në mbledhjen e radhes.

Mbledhja perfundoj:

11.25